




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

Kryetari i Komunës
01.Nr. 103/02-7764/19
Kaçanik, 13.03.2019

Në bazë të rregullores 2007/30 mbi ndryshimin e Rregullores 2004/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

I.

Me këtë vendim formohet Komisioni Komunal për vlerësimin e kushteve të eksploatimit të mineraleve dhe ndërrimit të destinimit të tokave bujqësore-pyjore, me këtë përbërje:

1. Mustafë Loku, kryetar i komisionit
2. Rakip Vishi, anëtarë dhe
3. Mentor Shehu, anëtarë

II.

Komisioni i më lartë shënuar ka për detyrë që të dalë në vendin e ngjarjes në përbërje të plotë dhe të veprojë sipas autorizimeve të cekura në pikën I të këtij Vendimi.

III.

Komisioni është i obliguar që lidhur me vendshiqimin e bërë të hartoj raport me shkrim dhe ta njoftoj Kryetarin e Komunës, Drejtorinë kompetente për vazhdimin e mëtejme të procedurës.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

V.


Me këtë vendim njoftohen: anëtarët e Komisionit dhe arkivi komunal.

Kryetari i Komunës:
Besim Ilazi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



Në mbështetje të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 8 të rregullores MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR PROJEKTPROPOZIMET E OJQ-VE

1. Me këtë vendim themelohet komisionit për vlerësimin e kandidateve për anëtarë të komisionit vlerësues me këtë përbërje:
 - a. **Murat Burrniku;**
 - b. **Sahadete Dalloshi;**
 - c. **Menduh Krasniqi.**
2. Ky komision është i obliguar që në afat optimal, të vlerësoj aplikacionet të cilat janë dorëzuar në bazë të thirrjes publike 01 Nr. 104/02-7020/19, pranë qendrës për shërbime me qytetar.
3. Detyrat, përgjegjësitë dhe forma e vlerësimit të kandidateve (formular etj.) janë të specifikuar në rregulloren MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
4. Pas përzgjedhjes në bazë të kriterëve, komisioni është i obliguar që t'i drejtohet zyrës së kryetarit me raport për kandidatët të cilët plotësojnë kushtet.
5. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi anëtarët nuk kanë të drejtë ankese.

Data 29.03.2019		Vendi KAÇANIK
Nr. org.	Numri	Shtojcë
01-104	02-9714	7.

Të njoftohen:

Anëtarët e komisionit;

Arkivi.



Kryetari i Komunës

z. Besim Hazi